



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 192 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të kërcënimeve të aktivistëve të subjektit politik LVV, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datën 17.06.2012 rreth orës 12:30 në fshatin Biqec në oborrin e shkollës “Jusuf Gërvalla” disa persona kanë qëndruar në oborrin e kësaj shkolle militante e PDK-së. Sipas pretenduesit të ankesës, aktivistët e LVV-së që po dërgonin ushqim tek vëzhguesit dhe komisionerët e LVV-së, fotografuan daljen e militantëve të PDK-së nga oborri i shkollës. Siç potencon ankuesi personat e rrethuar në foto kanë kërcënuar aktivistin tonë se nëse nuk i fshin fotot ai “do ta vrasë”. Ankuesi thekson se kanë kërkuar nga policia që ti përcjellin deri jashtë oborrit të shkollës, por ata u thanë se nuk kanë të drejtë të lëshojnë QV. Pasi kanë dalur nga oborri i shkollës, janë ndaluar nga militantët e PDK-së, ndër të cilën ishte edhe zyrtari i Komunës, Drejtori i Arsimit të Komunës së Kaçanikut, Azem Guri, të cilët ia kanë hapur derën e veturës, aktivistëve të LVV-së sipas parashtruesit të ankesës u kanë kërkuar telefonin me të cilin kanë fotografuar, duke kërcënuar aktivistët tonë, se nëse publikohen fotot me fytyrën tonë ne do të kemi punë ma vonë me ty. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast është bërë shkelje e nenit 177 të KPK-së, nei 4.1 i RRZ 11/2009 të Kodit të Mirsjelljes, nenit 2 par 2 pika 8 i Rregullës Zgjedhore 09/2009.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi në ankesë.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.06.2012, gjer në ora 15:00.

PZAP, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK thekson se, lidhur me pretendimin e LVV-së në ankesë, kinse janë kërcënuar nga militantet e subjektit politik PDK në përgjigjen në ankesë thekson se ka të bëjë me të kundërtën. Aktivisti i LVV Shabi Kodra ka penguar dhe provokuar votuesit duke bërë foto derisa ata ishin në proces të votimit.

Më datë 19.06.2012, PZAP-i ftoi në cilësinë e dëshmitarit Adonis Tahiri, aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje i cili deklaroi se: Më datën 17.06.2012, rreth orës 12:30, kam shkuar në fshatin Biqec, në shkollën “Jusuf Gërvalla”, për t’ua dërguar ushqimin komisionerëve dhe vëzhguesve tanë. Kam vërejtur praninë e personave të paautorizuar në oborrin e shkollës dhe aktivisti tjetër që ishte me mua, Shabi Kodra (nga Kaçaniku), i identifikoi dhe i fotografoi me telefon të gjithë ata që po qëndronin në oborrin e shkollës. Sipas aktivistit të LVV-së në deklaratë thekson se pas shpërndarjes së ushqimit dhe ku dola nga QV-ja, e kishin rrethuar shumë persona veturën e Shabi Kodres dhe po tentonin t’ia merrnin telefonin. Siç potencon dëshmitari në deklaratë njëri nga militantët e PDK-së, e dëgjova që thoshte se “nëse del diku fotografia ime, ki me pas punë me mua”. Në deklaratë theksohet se aktivistët e LVV-së kanë kërkuar nga policia që ti shoqërojë deri sa ti kalojnë personat që supozohen se i kanë kërcënuar mirëpo policia iu ka thënë se nuk kanë të drejtë të dalin jashtë QV-së. Dëshmitari ka deklaruar se policia i ka lënë nën shoqërimin e trupojës së Xhabir Zharkut. Në pyetjen e aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje se “ A mund ti besojmë këtij njeriu”?, policia është përgjigjur “Hajt se ky i joni është”. Pas daljes nga oborri dëshmitari thekson se militantët e PDK-së na kanë hapur derën e shoferit duke na kërcënuar se do të merrnin telefonin, me kërcënime se do të na vrasin, truproja e Xhabir Zharkut doli nga vetura dhe i largoi ata deri në momentin e nisjes. Pas nisjes vetura jonë u godit me shqelma nga mbrapa. Deklarata e Adonis Tahirit është dhënë dhe është nënshkruar më datë 19.06.2012 në PZAP.

PZAP-i, po ashtu më datë 19.06.2012 nëpërmjet postes elektronike kërkoi në Stacionin Policor në Kaçanik një raport policor lidhur me verifikimin e pretendimeve ankimore për Ankesën në fjalë.

Në Raportin Policor të datës 17.06.2012 theksohet se gjatë kohës së votimit e cila është hapur në ora 07:00 në oborrin e shkollës fillore “Jusuf Gërvalla” nuk ka pasur simpatizues të asnjërës parti politike dhe në perimetrin e hyrjes së oborrit të shkollës që është në largësi prej 50 metra kanë qëndruar disa persona në qetësi. Në Raport thuhet se gjatë tërë kohës kanë qenë në kontakt me menaxherin e QV-së Burim Bunjaku, mirëpo asnjëherë nuk kanë kërkuar ndihmën e policisë për ndonjë problem me simpatizantët e ndonjërës parti politike, apo ndonjë problem brenda, përbrenda objektit të shkollës dhe se me anë të këtij raporti ju njoftoj se në perimetrin ku kemi qenë të caktuar gjatë këtyre zgjedhjeve në fshatin Biqec gjithçka ka qenë në rregull.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Sipas ankesës së parashtruar në PZAP pala ankuese pretendon se në fshatin Biqec në oborrin e shkollës “Jusuf Gërvalla” kanë qëndruar militantë të subjektit politik PDK. Sipas ankuesit aktivistët të LVV duke bartur ushqimin për komisioner dhe vëzhgues të subjektit të tyre kanë fotografuar daljen e militantëve të PDK-së nga oborri i shkollës. Siç potencon ankuesi se nga personat e rrethuar në foto janë kërcënuar aktivistët e LVV-së, për shkak fotografive të bërë me telefon.

PZAP-i sipas Raportit Policor vërtetoi se gjatë ditës së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshëm në Kaçanik në fshatin Biqec, konkretisht në Shkollën Fillore “Jusuf Gërvalla” ku ekzistonte QV-ja, gjithçka ka qenë në rregull dhe nuk ka pasur grumbullim të simpatizantëve të partive dhe nuk janë vërejtur kërcënime, siç pretendohet në ankesë.

Andaj, PZAP-i, vlerësoi se pretendimet ankimore se janë bërë shkeljet e potencuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi për të vërtetuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë, pasi që nga fotot e ofruara si dëshmi në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se objekti i shkollës fillore “Jusuf Gërvalla” janë afër Qendrës së Votimit, ashtu siç potencohet në ankesë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 192 /2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**

